



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. Nr. 248/22**

**PSH. Nr. 328/22**

Paneli Shqyrtues i Prokurimit, i emëruar nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) në bazë të nenit 105 dhe 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës Nr. 04/L-042 (i amendamentuar), në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani- Kryetare, Nita Bejta- Referuese, dhe Vedat Poterqoi- Anëtar, pas shqyrtimit të kërkesës për diskualifikim (Nr. Protokolli 248/22), të ushtruar nga Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) të ushtruar ndaj ndaj Operatorit Ekonomik (OE) "EUROPRINTY" shpk, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me letër A-4 për nevojat e Komunës së Rahovecit" me numër të prokurimit 623-22-3784-1-3-6 dhe kërkesës së ushtruar për diskualifikim nga Komuna e Vushtrisë (Nr. Protokolli 328/22) në cilësinë e AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material shpenzues zyrtar, me numër të prokurimit VU644-22-4671-1-2-1, duke u bazuar në neni 16 (Rastet e unifikuara) të Rregullores së punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, lidhur me nenin 99 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës dhe nenit 32 të Rregullores së cituar të OSHP, me 25 tetor 2022, mori:

#### **V E N D I M**

1. Aprovohet si e bazuar kërkesa e Komunës së Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, e datës 01.07.2022 dhe kërkesa e Komunës së Vushtrisë, po ashtu në cilësinë e AK e datës 01.07.2022, kurse OE "EUROPRINTY" SHPK me numër të biznesit 810444878, diskualifikohet nga aktiviteti i prokurimit numër 623-22-3784-1-3-6 dhe aktiviteti i prokurimit numër VU644-22-4671-1-2-1 dhe nga pjesëmarrja në çdo aktivitet tjetër të prokurimit, për periudhën kohore në kohëzgjatje 3 muaj, duke filluar nga data 25.10.2022 gjer me datën 25.01.2023, për shkak të mospërbushjes së detyrimeve ligjore sipas nenit 65 lidhur me nenin 99, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me nenin 26.6 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (Janar 2021).

2. Urdhërohen Autoritete Kontraktuese (me shënime si më sipër) që ta konfiskojnë shumën e mjeteve të deponuara nga OE "EUROPRINTY" Shpk në emër të sigurimit të ofertës, siç parashihet me nenin 57, paragrafi 1.3, të LPP.

## **A r s y e t i m**

Komuna e Rahovecit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftim për dhenje të kontratës (për aktivitetin e prokurimit të cituar si në hyrje të këtij vendimi) duke rekomanduar për kontratë OE “Europrinty” Shpk. Për këtë arsye, me 17.05.2022 AK ka kërkuar nga OE që ti sjellë dokumentet e pranueshmërisë në mënyrë që të publikohet Vendimi lidhur me dhënien e kontratës. Dokumentet e pranueshmërisë në këtë rast nënkuptojnë: a) Sigurimin e tenderit; b) Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës; dhe c) Vërtetimin nga Gjykata. Me 17.05.2022 (të njëjtën datë), AK ka pranuar një njoftim (përmes postës elektronike) nga OE, i cili e ka informuar AK se nuk e posedon Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe nuk ka mundësi të njëjtin ta siguroj, prandaj ka propozuar që të nënshkruhet kontrata në mungesë të vërtetimit të cituar. Kurse me 18.05.2022, OE në rastin konkret e ka informuar AK (sërish përmes postës elektronike) se nuk mund ta nënshkruaj kontratën meqë është palë në një proces të papërfunduar gjyqësor. Për këtë arsye ka kërkuar interpretim nga KRPP i cili e ka njoftuar se nuk mund të nënshkruhet kontrata në mungesë të vërtetimit, prandaj dhe për këtë shkak i ka rekomanduar AK që të vazhdoj me tenderuesin e radhës.

Komuna e Rahovecit, po ashtu në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftim për dhenje të kontratës (për aktivitetin e prokurimit të cituar si në hyrje të këtij vendimi) duke rekomanduar për kontratë po ashtu OE “Europrinty” Shpk. Po ashtu edhe në këtë rast, AK ka kërkuar dokumentet e përshtatshmërisë, në mënyrë analoge sikurse në rastin e aktivitetit të prokurimit të përshtatshëm si më sipër, me ç’rast OE nuk ka arritur as në këtë rast ti siguroj dëshmitë e kërkuara.

Me 06.10.2022, Paneli Shqyrtues mbajti seancë dëgjimore me palë lidhur me aktivitetin e prokurimit të iniciuar nga Komuna e Rahovecit dhe po ashtu të njëjtën ditë ka konvokuar edhe seancën dëgjimore lidhur me aktivitetin e prokurimit të iniciuar nga Komuna e Vushtrrisë. Seancat dëgjimore janë mbajtur për ndriçimin e drejtë të gjendjes faktike në raport me pohimet e deklaruara nga OE dhe të AK.

Sipas propozimit paraprak të Kryetarit të OSHP dhe duke ju referuar nenit 16 (Rastet e unifikuara) të Rregullores së punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, Paneli Shqyrtues vendosi që të aplikohet bashkimi i lëndëve, meqë plotësohen kushtet e parashikuara sipas paragrafit 1, të nenit 16, të Rregullores së cituar (Rastet e unifikuara) sipas të cilit mund të bashkohen rastet e lidhura me lëndën e njëjtë të prokurimit. Lidhur me këtë, duke i administruar të gjitha provat dhe shkresat e këtyre lëndëve Paneli konstatoi se OE nuk ka arritur ti plotësoj detyrimet e parapara shprehimisht me nenin 65 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, lidhur me pikën 4.5; 4.6; 4.11. të paragrafit 4, të dispozitës së cituar. Paneli konstatoi se aktet dhe veprimet e autoriteteve kontraktuese në të dyja rastet përbejnë prova jo kontestuese, prandaj dhe në të dyja rastet autoritetet kontraktuese kanë qenë të detyruara të ndërmarrin veprime në kuptim të 99.2 të LPP. Në vështrim të shkresave të këtyre lëndëve, Paneli konstatoi se rrjedha e veprimeve dhe iniciimi i procedurës nga ana e AK është në harmoni me parimet e përgjithshme të LPP dhe si rrjedhojë kërkesat për diskualifikimin e OE kanë bazë ligjore, në kuptim të nenit 99.2 të LPP sipas të cilit OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa.

Paneli Shqyrtues, bazuar në kompetencat e parapara me nenin 105, të LPP, e komunikoi për të dyja autoritetet kontraktuese po ashtu Urdhërin për konfiskim të sigurimit të ofertës ndaj OE “Europrinty” Shpk. sipas pikës 2, të diapozitivit të këtij vendimi, me kusht nëse autoritetet kontraktuese (të cituara si më sipër) nuk e kanë aplikuar këtë masën e sigurimit në zbatim të nenit 57, paragrafi 1.3, të LPP, sipas të cilit “tenderuesit në fjalë i është dhënë kontrata përkatëse në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi pastaj refuzon ose dështon: (i) që të depozitojë çfarëdo sigurie të kërkuar të ekzekutimit që ishte specifikuar në dosjen e tenderit; (ii) që të përmbushë çfarëdo kushti tjetër që ishte specifikuar në dosjen e tenderit, para nënshkrimit të kontratës përkatëse, ose (iii) që të ekzekutojë një kontratë që përputhet më kushtet e specifikuara në dosjen e tenderit”.

Prandaj bazuar në të lartëcekurat dhe në bazë të nenit 99 par 2 të LPP-së, Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi

Kryetarja e Panelit  
Vjosa Gradinaj Mexhuani



**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, kurse pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet me padi Gjykatës Komerciale të Prishtinës në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t’i dorëzohet:

1x1 AK – KK Rahovec

1x1 AK – KK Vushtrri

1x1 OE “Europrinty” SHPK

1x1 Arkivës së OSHP

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP